

VENDIM
Nr.68, datë 7.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET SI REZULTAT I RRËSHQITJES SË
NDODHUR NË AKSIN RRUGOR ELBASAN-LIBRAZHD**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket si rezultat i rrëshqitjes së ndodhur në aksin rrugor Elbasan-Librazhd.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 385 m² tokë/arë, të vlerësuar me 350 lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 134 750 (njëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 133 000 (njëqind e tridhjetë e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 134 750 (njëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1.3.2007 dhe të përfundojë brenda 31.3.2007.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve të bëjë likuidimin e pronarit brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**PRONARI I PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET SI REZULTAT I
RRËSHQITJES TË NDODHUR NË AKSIN RRUGOR ELBASAN-LIBRAZHD**

Pronari	Z.K	Nr.pasurisë	Sipërfaqe arë/m²	Çmimi lekë/m²	Vlera në lekë	Vlera totale e shpronësimit
Muharrem Bozhiqi	1063	603/2	385	350	134 750	134 750

Vlera totale e këtij shpronësimi është 134 750 (njëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.